



UNMIK/REG/2005/44
8 shtator 2005

RREGULLORE NR. 2005/44
MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA
DHE TË MESME TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me kapitullin 8 dhe me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 8 prill 2005 lidhur me Ligjin për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të miratuar nga Kuvendi më 23 mars 2005,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo pushtetin dhe kompetencat e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 02/L-5) që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit, me kusht që në nenin 5 a) shprehja “siguruar” të zëvendësohet me “punoj me huadhënësit në sektorin privat për të siguruar”. Ky ndryshim do të paraqitet në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 8 shtator 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm